

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË E KONTROLLIT TË  
BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE ME OBJEKT “AUDITIMI I  
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE” PËR PERIU DHËN  
01.01.2014 – 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Agjencinë e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën 01.01.2014 deri në 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 35, datë 31.03.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1039/7, datë 31.03.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Zhan Levani, drejtor i Agjencisë së Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË  
LEGJISLACIONIN NË FUQI:**

1. Nga auditimi u konstatua mungesë të procedurave dhe rregullave në përputhje me të cilat duhet të veprojnë AKBPM për sekuestrimin dhe administrimin e barnave të sekuestruara. Nga auditimi konstatuam se nga Agjencia duhet të administroheshin barna me vlerë 103 179 667 leke të konfiskuara nga Sektori i Inspektimit (evidentuar nga procesverbalet përkatëse), nga të cilat 24 083 023 lekë barna ndodheshin në ambientet e AKBPM-S, ndërsa vlera prej 79 091 644 lekë ndodhej e bllokuar në ruajtje në depot farmaceutike (sipas listës së barnave të sekuestruara që i bashkëngjitet këtij Vendimi dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit). Në nenin 64 “Administrimi dhe asgjësimi i barnave të konfiskuara” të ligjit nr.105/2014 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” konstatohet mungesë e rregullave që përcaktojnë procedurën e sekuestrimit, mungesë që kanë krijuar problematika dhe qëndrime subjektive në vlerësimin e sekuestrove si në rastet e *Vaxigripit, Tranxene dhe të ndonjë bari tjetër*. Po kështu konstatuam mangësi të kësaj procedure në rregulloren e brëndshme të institucionit, *sa trajtuar në faqen 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

**1.1** Në ligjin nr.105/2014 datë 31.07.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, lidhur me “Mënyrën e sekuestrimit dhe administrimit të barnave” nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me AKBPM të kërkohet të bëhen amendimet e nevojshme për të rregulluar këto procedura dhe plotësuar hapësirat e konstatuara nga ky auditim

**1.2** Nisur nga rëndësia që ka rregullimi i kësaj problematike të punohet për t’i propozuar për miratim Këshillit të Ministrave një vendimi lidhur me “Procedurat e sekuestrimit të barnave dhe mënyën e administrimit e tyre”.

*Brenda 6 mujorit 2015*

**B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Referuar konstatimit nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, se një pjesë e tyre nuk kanë gjetur zbatim, gjë e cila ka bërë që problematika e konstatuar të mos gjejë përmirësim dhe të konstatohen sërish gjatë këtij auditimi *sa trajtuar në faqen 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

- Të analizohet me kujdes çdo rekomandim i mëparshëm dhe aktual me synimin e marrjes së masave të menjëhershme për zbatimin e tyre duke njoftuar në vijimësi KLSH mbi masat konkrete të ndërmarra.

#### ***Menjëherë***

**2.** Nga auditimi është konstatuar se, pronat e paluajtshme në administrim të AKBPM nuk janë regjistruar në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", *sa trajtuar në faqen 36-41 të Raportit Auditimit, është rekomanduar:*

- Të përgatitet dokumentacioni ligjor i pronësisë për objektet që i janë vënë në dispozicion institucionit nga Ministria e Shëndetësisë në zbatim të vendimit të KM, dhe të kryhet regjistrimi Pronave të Paluajtshme.

#### ***Menjëherë***

**3.** Nga auditimi u konstatua se: *Një sasi e konsiderueshme e artikujve dhe specifikesht "barna të ndryshme" u gjendën të vendosur në mënyrë të çrregullt në magazinë si dhe të ruajtura jashtë standardeve dhe kushteve. Gjatë verifikimit të tyre rezultoi se kjo sasi barnash të konfiskuara nga Agjencia ndër vite ishte e pa dokumentuar sipas procesverbaleve dhe sekuestrove të kryera, ndërkohë që nuk ishte kryer asnjë inventarizim për këto barna nga ish-QKKB sot AKBPM. Gjithashtu në këtë grumbull barnash u evidentuan kuti bosh (pa bar brenda tyre). Kjo sasi barnash e vendosur jashtë çdo standardi ishte e pandarë sipas afateve të skadimit, duke mbajtur sasira të konsiderueshme barnash të skaduara apo në limite të afatit të skadencës (shumë edhe për përdorim spitalor), sa trajtuar në faqen 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

-Nga AKBPM të merren masa të menjëhershme për inventarizimin e barnave të sekuestruara, ndarjen e barnave sipas qëllimit të përdorimit të tyre duke u bazuar në afatet e përdorimit të tyre.

-Për barnat e skaduara apo dhe në limitet e kohës së përdorimit të tyre, ti kërkohet miratimi dhe bashkëpunimi i menjëhershëm Ministrisë së Mjedisit për asgjësimin e tyre sipas parashikimeve të bëra në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

-Procedura e asgjësimit të dokumentohet me dokumentacion shkresor dhe financiar shoqëruar me pamje të qarta fotografike dhe filmike (dhe në raste të sasive të konsiderueshme edhe në prani të mediave, kjo duke patur parasysh ndjeshmërinë qytetare lidhur me këtë problematikë) si gjatë daljes së tyre nga ambientet e AKBPM-s dhe gjatë asgjësimit në vendin e përcaktuar nga Ministria e Mjedisit.

#### ***Menjëherë***

**4.** Nga auditimi mbi administrimin e mostrave të barnave të cilat dorëzohen gjatë aplikimit për regjistrim rezultoi se sasia e mostrave të dorëzuara në Agjenci nga aplikantët për regjistrim është 2426 mostra (665 lloje barnash). Mbajtja dhe administrimi i tyre bëhet në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 të MFK, pasi ato ruhen në një ambient të Agjencisë të pa inventarizuara dhe të pa identifikuar si "mostra" pa të drejtë përdorimi përveçse në ato raste që parashikohet ndryshe në ligj apo rregullore. Nga verifikimi i disa procedurave rezultoi se çdo njëri prej specialistëve të Sektorit të Regjistrimit në AKBPM merr në dorëzim sipas formatit të aplikimit, një sasi mostrash, të cilat thjesht i vendos në një ambient (të pa inventarizuara dhe me mungesë të dokumentave shoqëruese). Në këto kushte konstatuam mungesë të inventarit të përgjithshëm mbi sasitë e mostrave në administrim, atyre që i kanë kaluar afatet e skadencave apo specifika të tjera të lidhura për këto sasi barnash.

Institucioni nuk ka procedura dhe rregulla të qarta të shkruara që lidhen me evidentimin dhe përgjegjësinë e gjithsecilit për menaxhimin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin në momentin e skadencës së këtyre barnave, *sa trajtuar në faqen 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

- AKBPM në rregulloren e brendshme të përcaktojë procedura dhe rregulla të qarta që lidhen me evidentimin, dokumentimin dhe përgjegjësinë e gjithsecilit për menaxhimin, ruajtjen dhe përdorimin/asgjësimin e këtyre barnave. Çdo njëri prej specialistëve të Sektorit të Regjistrimit në AKBPM që merr në dorëzim sipas format aplikimit një sasi mostra barnash, të dokumentojë dhe magazinojë sasi të respektive, në të kundërt përgjegjësia materiale mbetet tek nëpunësi i regjistrimit.

- Rregullorja e administrimit të barnave si mostra të jetë e ndryshme nga barnat e sekuestruara nga ky institucion, por në çdo rast duhet që nga institucioni të ngrihet një database ku të jetë e regjistruar sasia, lloji, kompania si dhe afatet e skadencave.

#### **Menjëherë**

**5.** U audituan aspekte të lidhura me procesin e regjistrimit të barnave, respektimit të afateve të regjistrimit dhe ri-regjistrimit të barnave sipas dispozitave ligjore në fuqi për barnat si dhe vlerësimin të dokumentacionit të dosjeve të veçanta, nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore. U konstatua se për periudhën e auditimit janë regjistruar 380 barna të autorizuara për tregtim, u është rinovuar autorizimi për tregtim 405 barnave si dhe kanë dalë nga regjistri ose u është revokuar autorizimi për tregtim 166 barnave në total. Nga vlerësimi mbi respektimin e afateve të *regjistrimit* u konstatuan 92 raste ku janë tejkaluar afatet e përcaktuara në Rregulloren e Regjistrimit nr. 73, date 03.02.2009. Dosjet janë mbajtur me tepër se një vit (jashtë periudhës së auditimit) për shqyrtim nga ana e AKPMB-së, duke tejkaluar çdo afat të mundshëm të parashikuar, pa dokumentuar ndonjë arsye të qenësishme. Nga auditimi i *procedurave të përshejtuara* nuk u konstatuan raste me tejkalim të afateve të regjistrimit por në format e aplikimet nuk identifikohet qartë dhe saktësisht dorëzimi i mostrave dhe sasia e tyre. Lidhur me procesin e *ri-regjistrimit* konstatuam raste në të cilat janë tejkaluar afatet. Ndërsa praktikrat e *çregjistrimit* me propozimet për revokim dërguar MSH përgjithësisht janë kryer bazuar në kërkesat e kompanive për çregjistrim konform rregullores për regjistrimin e barnave por pa cilësuar arsyet pse ky bar duhet të dalë nga regjistri i barnave. ***Për këtë është rekomanduar:***

- Nga AKBPM në vijimësi të dokumentohet çdo arsye që sjell vonesa në regjistrim të barnave të ndryshme dhe të sigurohet një transparencë e plotë e vendimmarrjeve të cilat mund të jenë subjekte të kontestimeve dhe ankesave. Rritja e transparencës do të presë rrugën keqinformimit publik me pasoja në besueshmërinë e vendimmarrjes së këtij institucioni të rëndësishëm në rregullimin e tregut farmaceutik. Të sigurohet plotësimi i formateve të aplikimit me elementë bazuar në praktikrat më të mira të fushës për të mundësuar evidentim dhe mirëadministrim dhe të barnave të depozituara si mostra në institucion gjatë procesit të regjistrimit.

#### **Menjëherë**

**6.** Nisur nga auditimi i procedurës së importimit të një sasi barnash të paregjistruara, në vlerë total rreth 2 301 413 Euro, kryesisht për mjekim spitalor referuar 7 autorizimeve përkatëse të importit dhënë nga Ministri i Shëndetësisë dhe faktit se ky import është realizuar nga një kompani që nuk është *mbajtësi direkt i autorizimit të tregtimit nga prodhuesit, por përfshirë në një zinxhir importi të shpërndarë në shumë vende të deklaruara si vende origjine të këtyre barnave sa trajtuar në faqen 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

- Nga ana e institucionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të vlerësohet dhe rregullohet procedura me synim që të eliminohen praktikrat të cilat vënë në dyshim origjinalitetin e produkteve të cilat hyjnë në tregun farmaceutik dhe sidomos ato që përdoren për mjekim spitalor dhe që rrisin shqetësimin e publikut lidhur me produktet në këtë treg.

- Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë pajisja me autorizime për bar të paregjistruar të bëhet e kujdesshme dhe plotësisht e justifikuar bazuar në një verifikim të plotë nëse bari është i

regjistruar në regjistrin e barnave të publikuar, referuar ligjit nr.9323 datë 25.11.2004 “Për barnat dhe pajisjet mjekësore” neni 11 pika 2, si dhe ligjit të ri “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” 2014, dhe VKM nr.24, datë 22.01.2014 pika 3 ku shprehimisht thuhet se: “Barnat e parregjistruara mund të importohen vetëm kur nuk ka alternativë tjetër të rregjistruar dhe kur është i domosdoshëm për trajtimin e të sëmurëve...”, si dhe “Autorizimi për importimin e barnave të parregjistruar jepet vetëm për ata barna, që nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave”.

#### *Menjëherë*

7. Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Pulla Kontrolli me element sigurie për barnat” (me vlerë 15,607,800 lekë) për sasinë 43,500,000 copë, u verifikua se nga magazina ishin bërë dalje specialistes së shtypit 30,900,000 copë. Përdorimi i sasisë së pullave të bëra dalje nga magazina në sektorin e printimit vërtetohej vetëm nëpërmjet një regjistri personal mbajtur nga specialistja e printimit, por që nuk firmosej nga shefi i sektorit të inspektimit varësi e të cilit është ky sektor. Verifikimi dhe rakordimi mbi sasinë e pullave të shtypura, që nga shtypja, dorëzimi dhe evidentimi i pullave ndiqet vetëm nga një punonjëse. Rakordimi nga sektori i financës bëhet vetëm në vlerë dhe jo në sasi, dokumentimi i procesit mbahet nga kjo punonjëse; pa u mbikëqyrur apo verifikuar asnjëherë me daljet nga magazina, pullat e shtypura, pullat e evidentuara si skarco dhe të ardhurat e arkëtuara nga pullat, duke ju referuar sasive të furnizuara nga kontrata. Gjithashtu u konstatua se pullat skarco kompensoheshin ose zëvendësoheshin nga kompania prodhuese fituese e tenderit të pullave me të cilin është lidhur kontrata e furnizimit për vitin 2014, praktikë kjo e ndjekur dhe për vitin 2013 ku është kompensuar sasia prej 34,444 pulla të cilësuar skarco. Prodhimi nga kompania e sasive për zëvendësim pa një reklamim me shkrim nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me parashikimet e bëra në kontratën e furnizimit, duke vënë dukshëm në rrezik sigurinë e të drejtave të pronësisë intelektuale që i zotëron vetëm Autoriteti Kontraktor, sipas nenit 12 të kontratës pjesa IV Pronësia Intelektuale, ndryshe themi se prodhimi i tyre lë hapur shtegun për një abuzim të mundshëm të prodhimit dhe të sasive të pullave të paautorizuara nga autoriteti kontraktor, *sa trajtuar në faqet 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

-Të mbahen çdo muaj Akt-Rakordime midis sektorit të financës dhe sektorit të pullave, verifikimi dhe rakordimi mbi sasinë e pullave të shtypura, dorëzimi dhe evidentimi i tyre. Rakordimi nga sektori i financës të kryhet jo vetëm në vlerë por dhe në sasi, duke e dokumentuar procesin, mbikëqyrur dhe verifikuar daljet nga magazina, pullat e shtypura, pullat e evidentuara si skarco, të ardhurave të arkëtuara nga pullat në referencë të sasive të furnizuara nga kontrata.

- Prodhimi nga kompania e sasive për zëvendësim të kryhet mbas një reklamimi me shkrim nga autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të bëra në kontratën e furnizimit, duke mos vënë në rrezik sigurinë e të drejtave të pronësisë intelektuale që i zotëron vetëm Autoriteti kontraktor, referuar nenit 12 të kontratës pjesa IV Pronësia Intelektuale, duke eliminuar hapësirat e rrezikut të mundshëm të prodhimit të sasive të pullave të paautorizuara nga autoriteti kontraktor

#### *Menjëherë*

8. Referuar bilancit përmbledhës të vitit 2013, shuma e debitorëve të ndryshëm deri në fund të vitit 2013 nuk rezulton të ketë të përfshirë detyrimin për gjobat e vendosura. Kështu gjobat e vendosura të cilat sipas procesverbaleve të vëna në dispozicion nga sektori i Inspektimit nuk rezultoi të jenë të kontabilizuara dhe evidentuara. E gjithë kjo situatë tregon se sektorët nuk rakordojnë me njëri-tjetrin dhe se gjobat nuk janë të kontabilizuara në kontabilitet, për rrjedhojë me kalimin e viteve, këto shuma të detyrimeve të biznesit, si rezultat i mos zbatimit të akteve ligjore në fuqi “humbin”, pra nuk ekzekutohen dhe kjo tregon për një proces formal

në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të tregut farmaceutik. Për vitin 2014 njoftimi nga Sektori i Inspektimit për gjobat e vendosura në janar është bërë në muajin nëntor *sa trajtuar në faqet 36-41 të Raportit Përfundimtar Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

- Sektori i Inspektimit të rakordojë me sektorin Juridik dhe të Financës lidhur me gjobat e vendosura prej tij në kohën kur gjobiten subjektet dhe jo në fund të vitit me qëllim kontabilizimin e tyre në kohë si detyrime në kontabilitet, ndjekjen dhe ekzekutimin e tyre sipas parashikimeve dhe respektimit të afateve ligjore, për të evituar formalitetin në drejtim të kontrollit dhe monitorimit të tregut farmaceutik.

#### ***Vazhdimisht***

**9.** Nga auditimi konstatohet se dokumentimi dhe realizimi i të ardhurave institucionale, lidhur me gjobat, pullat, rregjistrimin e barnave, lejet e importit, etj nuk bëhet në mënyrën e duhur dhe me mungesë të elementëve identifikues si numrat serialë të faturave për arkëtim apo numri rendor i rregjistrimit manual dhe elektronik të praktikave që përpilohen sipas sektorëve, të cilat i përgjigjen mandateve përkatëse. Po kështu konstatuam se dokumentacioni i bankës nuk ka të bashkëlidhur praktikën përkatëse, duke e vështirësuar kontrollin dhe duke shmangur në një farë mënyre gjurmët e auditimit, për strukturat që i krijojnë të ardhurat *sa trajtuar në faqen 24-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

-Të mbahen çdo muaj Akt-Rakordime midis sektorit të financës dhe sektorët e tjerë mbi të ardhurat që krijojnë, ku të evidentohet numri rendor i regjistrimit manual dhe elektronik të praktikave që përpilon çdo sektor si dhe numrat e serive të faturave për arkëtim. Çdo e ardhur që krijohet duhet të ketë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin justifikues dhe detyrimisht dokumentacionin e bankës dhe faturat për arkëtim (financa, strukturat që krijojnë të ardhurat).

#### ***Menjëherë***

**10.** Referuar konstatimit se Rregullorja e Brendshme është e vitit 2006, dhe nuk i përshtatet korrektësisht strukturës organike të miratuar së fundmi si dhe detyrave të reja që u janë caktuar sipas ndryshimeve të bëra në ligjin e ri “Për barnat dhe Pajisjet mjekësore”, *sa trajtuar në faqet 56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

-Të hartohet menjëherë rregullorja e re, në përputhje me objektivat dhe organigramën e institucionit, ku ndryshimet ligjore të shoqërohen me plotësimin e saj me rregullat dhe detyrat për çdo pozicion pune, sipas përgjegjësive, referuar kjo dhe ligjit për MFK si dhe akteve në funksion të tij. Kjo rregullore të marrë miratimet përkatëse sipas përcaktimit në aktet ligjore.

-Në rregulloren e brendshme, të përcaktohet mënyra e vlerësimit të riskut në tregun farmaceutik dhe programimit të kontrolleve nga sektorët përgjegjës në referencë të problematikave kryesore të këtij tregu. Të përcaktohen me rregullore procedurat dhe afate të miratimit të këtyre programeve nga Titullari i Agjencisë.

#### ***Menjëherë***

**11.** Nga Auditimi, rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Agjencinë e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, nuk ka funksionuar, pasi Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë. Punonjësit, nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Nuk është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të AKBPM-s dhe nuk ka një Strategji, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

- Në këtë institucion po punohet me Draft Rregulloren e Brendshme të AKBPM-s, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, pjesë integrale e së cilës është edhe Kodi i Etikës, në të cilën përcaktohet konflikti i interesit dhe

deklarimi i tij, si dhe marrëdhëniet me të tretë etj., por pa përcaktuar mirë ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve.

- Nuk është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), sipas kërkesave të Ligjit për MFK, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të AKBPM, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor.

- Nga ana tjetër u konstatua se nuk monitorohet nga Titullari dhe strukturat e tij, sektorët në varësi të Sektorit të Inspektimit, sektorit të Financës në AKBPM, efektiviteti i sistemeve të kontrollit të këtyre njësive si dhe lidhur me objektivat e punës që ka gjithsecili. *Sa trajtuar në faqen 56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

- Të hartohet dhe miratohet Deklarata e Misionit të AKBPM-s dhe një Strategji, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

- Në Draftin e ri të Rregullores së Brendshme të AKBPM-s, të parashikohen raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, pjesë integrale e së cilës është edhe Kodi i Etikës, në të cilën të përcaktohet konflikti i interesit dhe deklarimi i tij, si dhe marrëdhëniet me të tretë etj., duke përcaktuar mirë ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve.

- Të krijohet Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), sipas kërkesave të Ligjit për MFK, të caktohet koordinatori i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të AKBPM, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor.

- Të monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, efektiviteti i të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të sektorëve të varësisë dhe të raportohet në vijimësi rezultatet e këtij monitorimi.

#### ***Menjëherë***

**12.** Nga auditimi u konstatua se drejtori i AKBPM me Urdhrin e Brendshëm nr.114 datë 22.05.2014 ka deleguar kompetencat e nëpunësit të autorizuar të njësisë publike te znj. Florida Dhrami e cila në strukturë është nëpunës zbatues, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, kjo në kundërshtim të nenit 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “ç”, Sa më sipër, vihet re se i njëjti person kryen disa funksione të cilat përbëjnë konflikt interesi me njëri tjetrin dhe nuk janë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin sa trajtuar në faqen 56-64 të Raportit Përfundimtar Auditimit.

***Për këtë është rekomanduar:***

- Drejtori i AKBPM-s të marrë përgjegjësitë ligjore si Nëpunës i Autorizuar duke vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, (neni 12), si dhe të jetë i vëmendshëm që nëpunësi zbatues, duhet të jetë nivel i menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të AKBPM.

#### ***Menjëherë***

**13.** Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. *Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë institucion pasi nuk lihen*

*gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të këtij institucioni sa trajtuar në faqen 56-64 e Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

- Të ngrihet një protokoll i brendshëm për korrespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave pasi kryerja e këtyre veprimeve do të ulë riskun e shmangies së përgjegjësisë institucionale të gjithsecilit në realizimin e funksioneve të ngarkuara.

***Menjëherë***

**14.** Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit, përpilimi i bilancit kontabël për aparatën e këtij institucioni rezultoi se ditari i veprimeve të hyrje dhe daljeve të magazinës regjistruhej nga specialistja e financës me një ditari të veçantë, të hartuar në excel, ku në fund të çdo muaji nxirret gjendja e llogarive që debitohej dhe kreditohen, pavarësisht se në institucion është i instaluar programi Financa 5, sa trajtuar në faqen 36-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:

- Me qëllim shmangien e gabimeve njerëzore si dhe për të rritur besueshmërinë e raporteve financiare, sektori i financës të bëjë regjistrimet kontabël dhe të përgatisë raportet financiare bazuar në programin financiar të instaluar në Institucion, Programi Financa 5.

***Menjëherë***

**15.** Gjatë auditimit të përdorimit të mjeteve të transportit, u konstatua se për vitin 2014 nga Titullari dhe struktura drejtuese e Shërbimit të Brendshëm nuk është ngritur komision i vlerësimit të mjeteve, komision i llogaritjes së harxhimit të karburantit për 100/km, apo të miratimit të formateve “Kërkesë për shërbim” dhe “Urdhrit apo autorizimit për shërbim”, në mënyrë të tillë që përdorimi i tyre të jetë i justifikuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore, sa trajtuar në faqen 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. ***Për këtë është rekomanduar:***

- Ngritjen nga Titullari dhe struktura drejtuese, të komisionit të vlerësimit të mjeteve, komisionit të llogaritjes së harxhimit të karburantit për 100/km, apo të miratimit të formateve “Kërkesë për shërbim” dhe “urdhrit apo autorizimit për shërbim”, në mënyrë të tillë që përdorimi i tyre të jetë i justifikuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

***Menjëherë***

**16.** Referuar konstatimit nga auditimi, se në AKBPM nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrolli, sa trajtuar në faqen 56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. ***Për këtë është rekomanduar:***

- Nga Titullari i institucionit, në AKBPM, Nëpunësi zbatues si dhe përgjegjës i sektorit të financës, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit, sipas udhëzimeve të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

***Menjëherë***

**17.** Nga auditimi lidhur me procedurat dhe afatet kohore për pajisjen me pulla dhe leje përdorimi për barnat e importuara u audituan disa praktika, në të cilat u vërejt se për numrin më të madh të dosjeve me barna të importuara pajisja me urdhra shtypi, leje përdorimi dhe pulla sigurie bëhej në një afat kohor të shpejtë ose maksimalisht 5 ditë, si dhe faktit që në disa procedura u konstatuan vonesa dhe ndryshime në afatet e nxjerrjes së Urdhrit të shtypit, pajisjes me leje tregtimi dhe pullat e sigurisë duke mos u trajtuar njësoj distributorët farmaceutik.

Gjithashtu referuar rasteve kur nga sektori i nxjerrjes së shtypit nxjerrja e Urdhrave të shtypit nuk ishte vetëm me barnat që do pajiseshin me pulla, por aty hidheshin dhe ato barna të cilat nuk kishin mangësi të dokumentacionit (selektuar me shenjën mohuese), praktikë që në gjykimin tonë influencon negativisht në tregtimin e barit në treg, pasi bari që pajisej me pullën e sigurimit, pa dalë leja e importit e cila ishte në vartësi të pajisjes së barnave të tjera që duhej të plotësonin dokumentacionin ose dilnin nga sektori i analizave, duke u ekspozuar ndaj riskut të tregtimit të barit pa leje përdorimi *sa trajtuar në faqen 41-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar:*

- AKBPM në rregulloren e brendshme të përcaktojë procedura dhe rregulla të qarta që lidhen me afatet kohore të çdo specialisti në zinxhirin e pajisjeve me pulla. Çdo njëri prej specialistëve të Sektorit në AKBPM të dokumentojë operacionin që kryen me synim që të sigurohet efikasiteti dhe të ndahet përgjegjësia e çdo punonjësi mbi procesin që kryen duke ulur ndjeshëm vonesat si dhe zgjatjen në kohë të pajisjes me pullat e sigurimit dhe hedhjen në treg të barit, duke e bërë transparent procesin dhe rritur besueshmërinë e publikut ndaj këtij institucioni.

- AKBPM në rregulloren e brendshme të përcaktojë një format të ri të Urdhrit të shtypit i cili të ketë ekstremitetet dhe formën e një dokumenti të rregullt administrativ dhe të eliminojë praktika të cilat mund të sjellin risqe operationale me ndikim negativ në tregun farmaceutik.

#### **Menjëherë**

**18.** Gjatë auditimit të procedurave të importit të barit RISPERIDONE ORAL solution 1mg/ml box x1 flaconx 30ml prodhues **C. M.** bar i regjistruar në regjistrin e barnave me nr. 467 datë 04.09.2009, importuar nga dy kompani farmaceutike **A-M** dhe **M** u konstatua si më poshtë:

Referuar çmimit CIF të publikuar dhe të miratuar nga Komisioni i Çmimeve ky bar rezulton me një çmim CIF 16.99 Euro, çmim i cili bazohet dhe pranohet vetëm sipas deklaramit të bërë nga vetë kompanitë importuese, dhe nuk ka asnjë analizë çmimi bazuar kjo në dokumente të cilat ta justifikojnë këtë çmim. Ndërkohë ky bar është importuar nga kompanitë e mësipërme dhe dokumentat shoqëruese të importit vërtetojnë një çmim prej 2,9 Euro shumë herë më të ulët se ai CIF prej 16.99 Euro gjë e cila ka çuar në hedhjen në treg të një bari me çmim shumë herë më të lartë. Nga verifikimi i faturës së shitjes lëshuar nga **C. M.** sipas porosisë së bërë nga **A-C** në datë 26.04.2010 është dërguar sasia 15 404 copë me çmim 2.9 Euro/copë ose në total 44 671 euro i pa shprehur ky çmim/njësi në lejen e importit, por deklaruar çmimi i referencës 2,991.7 lekë, çmim i cili ka dalë në treg. Për sa më lartë ky çmim është i pamundur të jetë për këtë bar, pasi referuar formulës përkatëse që përdoret nga Komisioni i Çmimeve në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe VKM nr.56 datë 28.01.2010 “për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave” ky bar mesatarisht duhet të kishte një çmim prej 751.66 lekë sipas formulës së llogaritjes (çmimi 2.9 Euro x kursi këmbimit (137.63) x marzhi i fitimit të shumicës (18%) x marzhin e fitimit të pakicës (33%) x 20% TVSH)= **751.66 lekë**. Diferenca midis çmimit/njësi të referencës (2,991.7 lekë) nga lista e çmimeve për barnat e rimbursueshme minus me çmimin/njësi (751.66 lekë) që duhej në fakt të tregtohej ky bar është **2,240.04 lekë** dhe për gjithë sasinë e barit të importuar kemi 15404 copë x 2,240.04 = **34,505,576 lekë**, vlerë që gjykojmë se është përfituar padrejtësisht nga kompania **AP-COM**, fakt që shoqërohet nga premisat e një evazioni fiskal.

Ndërsa nga verifikimi i faturës së shitjes lëshuar nga **C. M.** sipas porosisë së bërë nga **M** në datë 28.01.2011 është eksportuar sasia 14 770 copë me çmim 2.9 Euro/copë ose në total 42 883 euro i pa shprehur ky çmim/njësi në lejen e importit, por deklaruar çmimi 3.290,87 lekë, çmim i cili ka dalë në treg, ndërkohë që çmimi i referencës në listën e disbursimit është 1998 leke. Për sa më lartë ky çmim është i pamundur të jetë për këtë bar, pasi referuar formulës



përkatëse që përdoret nga Komisioni i Çmimeve në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe VKM nr.56 datë 28.01.2010 “për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave” ky bar mesatarisht duhet të kishte një çmim prej 751.66 lekë sipas formulës së llogaritjes (çmimi 2.9 Euro x kursi këmbimit (137.63) x marzhi i fitimit të shumicës (18%) x marzhin e fitimit të pakicës (33%) x 20% TVSH)= **751.66 lekë**. Bari ka dalë në treg sipas çmimit të përcaktuar në lejen e përdorimit, pra 3.290,87 me diferencë 1,293 lekë nga çmimi i referencës në listën e disbursimeve që ka qenë 1,998 lekë. Diferenca midis çmimit/njësi sipas lejes së përdorimit (2539.24 lekë) minus me çmimin/njësi (751.66 lekë) që duhej në fakt të tregtohej ky bar është **2539.24 lekë** dhe për gjithë sasinë e barit të importuar kemi 14770 copë x 2539.24= **37 504 575 lekë**, vlerë që gjykojmë se është **përfitur padrejtësisht nga kompania M, fakt që shoqërohet nga premiset e një evazioni fiskal**. Bari RISPERIDONE ORAL solution 1mg/ml box x1 flaconx 30ml prodhues **C. M.** konstatohet se është në listën e rimbursimit të barnave i radhitur i treti, dhe se për periudhën 2009-2014 ky bar duhet të plotësonte kërkesat e tregut sipas detyrimit për barnat e rimbursueshëm, në fakt ky bar i mungon tregut prej tre vjetësh.

Nisur nga mospërputhja e çmimeve CIF të deklaruara të barnave pranë Komisionit të Çmimit të Barnave dhe çmimeve të deklaruara në faturat e paraqitura për marrjen e Autorizimit për hedhjen në treg të këtyre barnave, sa trajtuar në faqen 80-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **është rekomanduar:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me AKBPM dhe Ministrinë e Shëndetësisë (Komisionin e Çmimit të Barnave), të verifikojë nëse ka patur evazion fiskal të shkaktuar nga kompanitë e përfshira në praktikën e mësipërme të importit apo dhe rasteve të ngjashme të denoncuar lidhur me importe të barnave, për të minimizuar praktikën abuzuese në tregun farmaceutik

- Komisioni i Çmimit të Barnave në Ministrinë e Shëndetësisë të marri masa për të vendosur procedurë që do të mundësonin verifikimin dhe dokumentimin e mospërputhjeve të çmimeve CIF të barnave, deklaruar nga Kompanitë Farmaceutike dhe çmimeve të deklaruara në faturat e paraqitura për marrjen e Autorizimit për hedhjen në treg të këtyre barnave, me qëllim, shmangien e praktikave të cilat japin mundësi përfitimeve të padrejta dhe ndikojnë në sjelljen në tregun farmaceutik të firmave.

#### **Menjëherë**

**19.** Gjatë auditimit të procedurave rregjistrimit të barit RISPERIDONE ORAL solution 1mg/ml box x1 flaconx 30 ml prodhues **C. M.** bar i regjistruar në regjistrin e barnave me nr.467 datë 04.09.2009 u konstatuan mungesa dokumentare të lidhura me kërkesën për aplikim rregjistrimi të barit, si emri dhe kompania që aplikon për rregjistrim ose personi i autorizuar nga kompania prodhuese **C. M.**, apo dokumenta të cilat janë **fotokopje të panoterizuara**. Çertifikata e origjinës tregon që dërguesi i barit është **C. M.**; origjina e barit specifikohet **JORDANI** dhe e konfirmuar nga Dhoma e Tregtisë së Irlandës ndërkohë që në Ligjin nr.9323 datë 25.11.2004 “Për barnat dhe pajisjet mjeksore” neni 13, shprehimisht thuhet: *QKKB-ja pranon për rregjistrim vetëm barnat nga prodhues vendas, barnat e regjistruara dhe që qarkullojnë në një nga vendet e Bashkimit Europian, SHBA, KANADA, JAPONI, AUSTRALI, si dhe në shtetet e Ballkanit Perendimor të përfshira në marrëveshjet e ratifikuara për tregtinë e lirë.*

- Gjatë auditimit të procedurave të lejeve të importit u konstatua se edhe për sasinë e barnave të importuara si të paregjistruara, gjatë muajve korrik-dhjetor 2014 në vlerë kryesisht për mjekim spitalor, nga Distributori **D** janë parqitur në Agjenci dokumentat, të cilat janë **fotokopje të panoterizuara**. Çertifikata e origjinës tregon që produkti eksportohet nga një kompani **Turke**; ku dhe vetë kjo kompani këto barna i ka të origjinës nga Porto Rico, Gjermani, Suedi, Zvicër, Angli, USA, Irlandën etj, pra çertifikata e origjinës nuk është nga

prodhuesit e barnave gjithashtu dhe në Deklaratat e zhdoganimit tregon se barnat që vijnë nga Kosova nga dega e **D** Kosove sipas autorizimit të Ministrit, por që në fakt si vend origjine të tyre deklarohen vende të ndryshme. I gjithë zinxhiri i importit i shpërndarë në shumë vende të deklaruara si vende origjine të këtyre barnave, gjykojmë që shpang paraqitjen në mënyrë të drejtëpërdrejtë të autorizimit të prodhuesit, të cilin në fakt kjo kompani nuk e zotëron, *sa trajtuar në faqen 80-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

- Sektori i Inspektimit në AKBPM të marrë masa të menjëhershme që në asnjë rast të mos lejojë pajisjen me pullë sigurie për tregtim bari, të distributorëve farmaceutik pa paraqitur më parë autorizim nga prodhuesi për tregtim të barit dhënë nga kompania prodhuese, certifikatë origjine e cila lëshohet vetëm nga prodhuesi, deklarata doganore e zhdoganimit të barit, CMR e transportit e cila përshkon rrugën që ka bërë produkti për tu futur në Shqipëri si dhe akt-verifikimin nga inspektorët e AKBPM-s mbi përputhshmërinë e barit të deklaruar me atë të importuar në fakt në depon e distributorit. Të gjitha këto dokumente duhet të jenë origjinale nga prodhuesi ose mbajtësi i autorizimit për tregtim, kjo me qëllim që të mund të kontrollohet origjina e barit dhe të mos ekzistojë mundësia e importimit të një bari të falsifikuar ose të ruajtura e transportuar në kushte jashtë standardit.

*Menjëherë*

### **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

1. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat sa më poshtë vijon :

- Nga Auditimi i kryer mbi listë pagesat e përzgjedhura, u përqendrua në raportet mjekësore veçanërisht në llogaritjen e ndalesave të pambajtura mbi to. U konstatuan disa raste në të cilat nuk janë ndalur sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me Ligjin 7703, dt. 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 7870, dt. 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me Ligjin nr. nr. 9136, dt. 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me VKM nr. 1114, dt. 30.07.2008, e ndryshuar; me Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, *sa trajtuar në faqen 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

- Të bëhen ndalesat për çdo detyrim të pandaluar për vitin 2014, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore detyrimet e pandalura për tatimin mbi të ardhurat janë 91,590 lekë, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat paguhen nga punëmarrësi janë 84,885 lekë, dhe nga punëdhënësi janë 113,644 lekë.

*Menjëherë*

- Nga auditimi i normativave të shpenzimit të karburantit u konstatua se në total automjeti Volkswagen Touareg i tipit 7 LA prodhim i vitit 2004 me targë 91-76 N, me normativat të miratuara 24-35 litra/100 km ka përshkruar 14503 km dhe konsumuar 2058.9 litra x 179.78 = 370 149 lekë, karburant më shumë se normativat e përcaktuara në manualin e këtij tipi makine, *sa trajtuar në faqen 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar:*

-Të ngrihet një komision mbi verifikimin e normativave të automjetit dhe km të përshkuara si dhe kontrollin teknik të tij, lidhur me shpenzimin e karburantit, sasinë e harxhuara të karburanit më shumë se normativat e përcaktuara në manualin e këtij tipi makine, në të kundërt të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin e dëmit për sasinë prej 2058.9 litra x 179.78 = 370 149 lekë .

## **Menjëherë**

2. Nisur nga rasti i importit të barit RISPERIDONE ORAL solution 1mg/ml box x1 flaconx 30ml prodhues **C. M.**, importuar nga dy kompani farmaceutike **A-C** dhe **M** ku konstatoam se nga diferenca midis çmimit/njësi të referencës nga lista e çmimeve për barnat e rimbursueshme dhe çmimit/njësi që duhej në fakt të tregtohej ky bar, vlera 34,505,576 lekë është përfituar padrejtësisht nga kompania **A-C**, ndërsa vlera 37,504,575 lekë është përfituar padrejtësisht nga kompania **M**, situatë e shoqëruar me elementë të evazionit fiskal. **Është rekomanduar**

- Ministri i Financave pas inspektimit financiar në Komisionin e Çmimeve dhe Barnave dhe AKBPM, bazuar në verifikimin e plotë të dokumentacionit financiar që shoqëron këtë ngjarje të kërkojë shpërblimin e plotë të shumës së përfituar padrejtësisht nga personat që kanë krijuar mundësinë e përfitimit të kësaj shume nga kompanitë për shkak të papërgjegjshmërisë në realizimin e funksionit të tyre shtetëror si dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur ligjore për vënien e tyre përpara përgjegjësisë.

## **D. MASA DISIPLINORE**

*D.1 Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës si dhe Kontratës Individuale të Punës për personat të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi, në këtë Raport Përfundimtar Auditimi konstatuar si në rastet e sekuestrimit, importimit të barnave kalimit të afateve të procedurave të regjistrimit, pajisjeve me pulla, hartimit të urdhrave të shtypit, MFK, procedurave të administrimit të pronës, i është rekomanduar Titullarit të AKBPM-s në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të bëjë vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore nga “vërejtje” deri në “zgjidhje të kontratës së punës” në raport me shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

*D.2 Nisur nga rëndësia dhe ndjeshmëria e madhe në lidhje me rregullimet që kërkon tregu farmaceutik si dhe kërkesa për rritje të influencës së autoriteteve kontrolluese dhe monitoruese në këtë treg bazuar në gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në këtë Raport Auditimi, i është rekomanduar Ministrisë së Financave që në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të analizojnë gjendjen në AKBPM dhe punën e Komisionit të Çmimeve të Barnave duke synuar përmirësimin e kornizave ligjore në të cilat evidentohen hapësirat që kanë sjellë një treg jo plotësisht të formalizuar dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës në institucionet respektive të varësisë.*

## **E. TË TJERA**

Duke u nisur nga gjetjet e konstatuara në këtë auditim, lidhur me shërbimin farmaceutik dhe barnat në Shqipëri si dhe rolin dhe kompetencat që ka Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore si rregullator dhe mbikëqyrës i këtij tregu, në mbrojtje të qytetarëve shqiptar, sa trajtuar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit. **Për këtë është rekomanduar:**

- Planifikimin e një auditimi performance në Agjencinë e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Komisionin e Çmimeve në Ministrinë e Shëndetësisë mbi efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomikitetin e këtij Institucioni si rregullator dhe mbikëqyrës i këtij tregu.

### ***Në vazhdimësi***

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Valentina Sulo përgjegjëse grupi, Mariola Lleshi dhe Kozma Kondakçi, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**